



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.38**

**2006**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9500  
datë 3.4.2006

Për ratifikimin e protokollit shtesë, për luftën kundër  
terrorizmit, të marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve  
pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi për  
bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht në  
format e organizuara të tij 1175  
.....

Ligj nr.9501  
datë 3.4.2006

Për ratifikimin e Traktatit të krijimit të Komunitetit të  
Energjisë 1179  
.....

Ligj nr.9512  
datë 10.4.2006

Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë  
22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”..... 1199

Ligj nr.9513  
datë 10.4.2006

Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9268, datë  
29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit  
Mbikëqyrës të  
Sigurimeve”..... 1201

**L I G J**  
**Nr.9500, datë 3.4.2006**

**PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË, PËR LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT, TË MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERIVE TË SHTETEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI PËR BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT, VEÇANËRISHT NË FORMAT E ORGANIZUARA TË TIJ**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Ratifikohet Protokolli shtesë, për luftën kundër terrorizmit, të Marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht në format e organizuara të tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4834, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**PROTOKOLL SHITESË**  
**PËR LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT I MARRËVESHJES MIDIS QEVERIVE TË SHTETEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI MBI BASHKËPUNIMIN NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT, VEÇANËRISHT TË ORGANIZUAR TË TIJ**

**Hyrje**

Qeveritë e shteteve anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ): Republikës së Shqipërisë, Republikës së Armenisë, Republikës së Azerbajxhanit, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Greqisë, Republikës së Moldavisë, Republikës së Rumanisë, Federatës Ruse, Serbisë dhe Malit të Zi, Republikës së Turqisë, Gjeorgjisë, Ukrainës, të quajtura më poshtë si “Palë Kontraktuese”,

*duke qenë* Palë Kontraktuese në Marrëveshjen midis qeverive të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë në format e organizuara të tij, firmosur në Korfuz më 2 tetor 1998, të quajtur shkurtimisht “Marrëveshja e BEDZ-it”;

*duke ndjekur* dispozitat e kartës së BEDZ-it, Deklaratën e Samitit Dhjetëvjeçar të Stambollit, Deklaratën e takimit të pestë të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të shteteve anëtare të BEDZ-it bërë më datë 26 tetor 2001, si dhe Deklaratën e Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të shteteve anëtare të BEDZ-it mbi kontributin e BEDZ-it për sigurinë dhe stabilitetin, bërë më datë 25 qershor 2004, të cilët dënojnë ashpër terrorizmin ndërkombëtar si një kërcënim global për paqen dhe sigurinë;

*të vetëdijshme* se terrorizmi në të gjitha format dhe manifestimet e tij është një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, stabilitetin politik, ekonomik dhe social të Palëve, për integritetin dhe sigurinë territoriale të shteteve anëtare të BEDZ-it, si dhe për zhvillimin e

marrëdhënieve miqësore dhe të fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh ndërmjet shteteve të rajonit të Detit të Zi;

*duke marrë* në konsideratë dispozitat e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara mbi luftën kundër terrorizmit dhe mbështetjen e plotë për rezolutat e Këshillit të Sigurimit në këtë fushë, në mënyrë të veçantë rezolutës 1373;

*duke nënvizuar* se lufta kundër terrorizmit duhet të kryhet në respektim të plotë të ligjit dhe të drejtave të njeriut;

*duke konfirmuar* mbështetjen e tyre të qartë për parimet universale të së drejtës ndërkombëtare,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

#### Neni 1

Për qëllime të këtij protokollit shtesë terrorizëm nënkupton ato krime që përcaktohen si të tilla në konventat dhe protokollet e Kombeve të Bashkuara mbi luftën kundër terrorizmit.

#### Neni 2

Palët do të bashkëpunojnë për parandalimin, zbulimin, goditjen, demaskimin dhe hetimin e akteve të terrorizmit në bazë të Marrëveshjes së BEDZ-it dhe këtij protokollit shtesë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, si dhe me angazhimet ndërkombëtare të tyre.

#### Neni 3

1. Palët do të përcaktojnë autoritetin/autoritetet e tyre kompetente dhe/ose pikën/pikat e kontaktit nëpërmjet të cilave mundësohet komunikimi i drejtpërdrejtë.

2. Çdo Palë do t'i paraqesë Depozitarit një listë me emrat dhe koordinatat e autoritetit/autoriteteve kompetente të saj dhe pikës/pikave të kontaktit brenda një periudhe dymujore mbas hyrjes në fuqi të këtij protokollit shtesë për atë Palë. Palët do të informojnë Depozitarin për çdo ndryshim në këtë listë.

#### Neni 4

1. Në mënyrë që të zbatojnë këtë protokoll shtesë, Palët do të ndërveprojnë në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjes së BEDZ-it (marrëveshjes për krijimin e BEDZ-it) dhe të protokollit shtesë të Marrëveshjes së BEDZ-it, bërë në Kiev, më 15 mars 2002.

2. Nëse është e nevojshme, Palët mund të krijojnë linja komunikimi urgjente, të kryejnë takime dhe konsultime të rregullta ose të jashtëzakonshme.

#### Neni 5

Brenda kuadrit të Marrëveshjes së BEDZ-it dhe këtij protokollit shtesë, Palët do të shkëmbejnë informacion të interesit të ndërsjellë, në mënyrë të veçantë për:

a) aktet e terrorizmit të planifikuara dhe të drejtuara kundër udhëheqësit të shtetit, personave që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare, anëtarëve të misionëve dhe konsullatave diplomatike, zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare ndërqeveritare, pjesëmarrësve në vizita shtetërore, si dhe në ngjarje kombëtare/ndërkombëtare dhe kundër zyrtarëve dhe civilëve;

b) organizatat terroriste, grupet ose personat terroristë që paraqesin kërcënim për sigurinë e shteteve të tyre, si dhe kontaktet ndërmjet këtyre organizatave terroriste, grupeve apo personave terroristë;

c) tentativat dhe aksionet terroriste të drejtuara kundër sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve të Palëve;

d) aktet e terrorizmit dhe kërcënimet për kryerjen e akteve të tilla në territorin e shteteve të Palëve, kundër qendrave ekonomike, teknologjike dhe ekologjike dhe sistemeve të rëndësisë jetike;

e) organizatat dhe grupet terroriste që veprojnë në territorin e shteteve të Palëve, taktikat dhe

metodat e tyre, udhëheqësit, anëtarët, si dhe personat e përfshirë në dhe/ose mbështetjen e aktiviteteve të këtyre grupeve ose organizatave;

f) organizatat dhe institucionet që mbështesin terrorizmin, për mekanizmat, përhapjen dhe drejtimin e kësaj mbështetje;

g) trafikimin e paligjshëm të armëve, përfshirë municioneve, lëndëve eksplozive dhe kurtheve me eksploziva, materialeve dhe burimeve bërthamore dhe radioaktive, armëve kimike dhe biologjike dhe komponentëve të tyre, të kryer nga personat dhe grupimet e organizuara kriminale, kanalet e përdorura për transportimin e paligjshëm të tyre nëpër territorin e shteteve të Palëve;

h) burimet e zbuluara dhe të dyshuara dhe kanalet e mbështetjes financiare logjistike ose llojeve të tjera të mbështetjes materiale për organizatat dhe grupet terroriste;

i) praktikën dhe legjislacionin mbi kundër-terrorizmin.

#### Neni 6

Palët do të punojnë dhe do të kryejnë bashkëpunim të ngushtë, në mënyrë të veçantë për:

a) shtypjen e përgatitjes dhe kryerjes së akteve të terrorizmit, si dhe të dhënies për terroristët së ndonjë forme të mbështetjes, përfshirë mbështetjen financiare;

b) refuzimin e strehës së sigurisë për ata që financojnë, planifikojnë, mbështesin ose kryejnë akte terroriste;

c) zbulimin dhe shkatërrimin e vendeve ku kryhet stërvitja e terroristëve, planifikimi dhe përgatitja e akteve të terrorizmit, nëse paraqiten evidenca konkrete;

d) parandalimin e lëvizjes dhe shkatërrimin e segmenteve të udhëtimit të terroristëve dhe grupeve terroriste;

e) zbulimin dhe identifikimin e strukturave të përdorura nga grupet ose organizatat terroriste për fshehjen e aktiviteteve të tyre;

f) parandalimin, zbulimin dhe goditjen e mbështetjes financiare, shpërndarjes së armëve dhe municioneve, substancave eksplozive, kurtheve me eksploziva, materialeve dhe burimeve bërthamore dhe radioaktive, armëve kimike dhe biologjike dhe komponentëve të tyre, si edhe dhënien e çdo asistence për personat apo organizatat për planifikimin, përgatitjen dhe kryerjen e akteve të terrorizmit.

Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për rezultatet e aksioneve bashkëpunuese.

#### Neni 7

Palët do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar përgatitjen e akteve të terrorizmit në territorin e shteteve të tyre, kur këto akte të terrorizmit do të kryhen në territorin e shteteve të palëve të tjera, si edhe për të refuzuar azilin për personat të cilët kanë planifikuar, lehtësuar ose marrë pjesë në përgatitjen e akteve të terrorizmit.

#### Neni 8

Palët mund të bashkëpunojnë për të arritur zbatimin e këtij protokolli shtesë në format e mëposhtme:

a) arsimimin, trajnimin dhe rritjen e aftësive profesionale të personelit;

b) shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave në lidhje me përdorimin e metodave shkencore dhe teknologjike për kërkimet shkencore në lidhje me krimet;

c) kryerjen e trajnimeve, seminareve, konsultimeve dhe kërkimeve shkencore të përbashkëta;

d) shkëmbimin e legjislacioneve të brendshme përkatëse, të dhënave statistikore dhe analitike;

e) dhe forma të tjera të parashikuara në Marrëveshjen e BEDZ-it.

#### Neni 9

Informacionit dhe dokumenteve të përftuara në kuadrin e këtij protokolli shtesë do t'u jepet e njëjta shkallë konfidencialiteti nga Pala e Kërkuar që u garantohej informacioneve të tjera të ngjashme të Palës Kërkuese:

1. Informacioni dhe dokumentet e përfthuara në kuadrin e këtij protokoll shtesë, si dhe informacioni mbi metodat e hetimit dhe taktikat e përdorimit të pajisjeve dhe/ose materialeve të posaçme nuk do t'u transmetohet palëve të treta pa autorizimin paraprak me shkrim bërë nga Pala Dërguese.

2. Informacioni ose rezultatet për pajtimin me kërkesën e marrë nga Pala tjetër në bazë të këtij protokoll shtesë nuk mund të përdoren për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë kërkuar ose janë paraqitur pa autorizimin paraprak me shkrim të bërë nga Pala Dërguese.

3. Shpërndarja dhe mbrojtja e informacionit të klasifikuar do të kryhet nga Palët, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe/ose marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare.

4. Pa cenuar angazhimet ndërkombëtare në këtë fushë të shteteve anëtare, Palët në Marrëveshjen e BEDZ-it dhe në këtë protokoll shtesë, të dhënat personale të marra në kuadrin e këtij protokoll shtesë do të gëzojnë të paktën të njëjtën mbrojtje që i jep Pala Dërguese.

#### Neni 10

Secila Palë do të përballojë në mënyrë të pavarur shpenzimet që lindin gjatë zbatimit të këtij protokoll shtesë, me përjashtim kur vendoset ndryshe në mënyrë të ndërsjellë për raste të veçanta.

#### Neni 11

Me qëllim sigurimin e bashkëpunimit në kuadrin e këtij protokoll shtesë, Palët do të përdorin gjuhën angleze gjatë procedurës shkresore, gjuhën angleze dhe ruse në procedurën gojore, me përjashtim kur Palët kanë rënë dakord ndryshe në mënyrë të ndërsjellë.

#### Neni 12

1. Zbatimi i këtij protokoll shtesë është subjekt i legjislacionit të shtetit të secilës Palë.  
2. Ky protokoll shtesë nuk do të pengojë detyrimet e tjera ndërkombëtare të shteteve palë.  
3. Çështjet e diskutueshme të cilat mund të lindin në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij protokoll shtesë do të zgjidhen nga palët e interesuara nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave, në përputhje me rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare.

#### Neni 13

1. Sekretariati i Përhershëm Ndërkombëtar (SPN) i BEDZ-it do të jetë Depozitari i këtij protokoll shtesë.

2. Origjinali i këtij protokoll shtesë në një kopje të vetme në gjuhën angleze do të depozitohet pranë Sekretariatit të Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it, i cili do t'i transmetojë kopje të certifikuara secilës Palë.

3. SPN i BEDZ-it do të informojë shtetet anëtare të BEDZ-it për:

- a) çdo akt firmosje;
- b) çdo paraqitje instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
- c) çdo datë hyrjeje në fuqi të këtij protokoll shtesë;
- d) çdo akt ose dokument tjetër njoftimi që lidhet me këtë protokoll shtesë.

#### Neni 14

1. Ky protokoll shtesë do të jetë i hapur për firmosje nga çdo shtet anëtar i BEDZ-it.  
2. Pala e cila ka firmosur këtë protokoll shtesë nuk mund të bëhet palë në të nëse nuk bëhet më parë palë në Marrëveshjen e BEDZ-it.  
3. Ky protokoll shtesë është subjekt ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi.  
4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes në fuqi do të depozitohen te Depozitari.

#### Neni 15

1. Ky protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës në të cilën instrumenti i tretë i ratifikimit, pranimit, miratimit ose i aderimit depozitohet te sekretari i përhershëm i BEDZ-it.

2. Për secilën Palë, e cila ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë protokoll shtesë pas hyrjes në fuqi të tij, ky protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit nga ajo Palë të instrumenteve përkatëse.

#### Neni 16

1. Secila Palë mund të propozojë amendamente të këtij protokoll shtesë.

2. Këto amendamente do të pranohen mbi bazën e miratimit prej të gjitha palëve dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të nenit 14 dhe me nenin 15 të këtij protokoll shtesë.

#### Neni 17

Çdo Palë mund të tërhiqet ose ta denoncojë këtë protokoll shtesë nëpërmjet njoftimit zyrtar dërguar Sekretariatit të Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it. Tërheqja ose denoncimi do të hyjë në fuqi brenda tre muajve pas datës në të cilën njoftimi për tërheqjen ose denoncimin merret nga Sekretari i Përhershëm Ndërkombëtar i BEDZ-it.

Dëshmitarë të sa më lart, nënshkruesit, të autorizuar ligjërisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë protokoll shtesë.

Bërë në Athinë, Greqi, më 3.12. 2004, në dy kopje të vetme në gjuhën angleze.

(Firmat përkatëse të përfaqësuesve të shteteve anëtare të BEDZ-it, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Armenisë, Republikës së Azerbajxhanit, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Greqisë, Republikës së Moldavisë, Republikës së Rumanisë, Serbisë dhe Malit të Zi, Republikës së Turqisë, Federatës Ruse, Gjeorgjisë dhe Ukrainës, pasojnë).

### L I G J

**Nr.9501, datë 3.4.2006**

#### **PËR RATIFIKIMIN E TRAKTATIT TË KRIJIMIT TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **V E N D O S I:**

##### Neni 1

Ratifikohet Traktati i krijimit të Komunitetit të Energjisë.

##### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4835, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

#### **TRAKTATI I KRIJIMIT TË KOMUNITETIT TË ENERGJISË**

Palët, të cilat janë:

Komuniteti Europian, nga njëra anë dhe

Palët Kontraktuese të mëposhtme, nga ana tjetër:

- Republika e Shqipërisë, Republika e Bullgarisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, ish-Republika Federale e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi, Rumania, Republika e Serbisë, Republika e Turqisë<sup>1</sup>, në njëërën anë (Palët Aderuese) dhe

- misioni i UNMIK në Kosovë, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,

*në konsolidim të Procesit të Athinës dhe memorandumëve të mirëkuptimit të Athinës 2002 dhe 2003,*

*duke pasur parasysh që Republika e Bullgarisë, Rumanisë, Republika e Turqisë<sup>2</sup> dhe Republika e Kroacisë janë vende candidate për hyrje në Bashkimin Europian, dhe që ish-Republika e Jugosllave e Maqedonisë ka bërë gjithashtu kërkesën për anëtarësim;*

*duke pasur parasysh që Këshilli Europian konfirmon në dhjetor 2002 në Kopenhagë perspektivën europiane të Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe Serbisë e Malit të Zi, si kandidatë të mundshëm për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe theksoi vendosmërinë për të mbështetur përpjekjet e tyre për t'u afruar edhe më në Bashkimin Europian;*

*duke pasur parasysh që Këshilli Europian miratoi në qershor 2003, në Selanik "Axhendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor: rruga drejt integritetit europian" që synon të forcojë më tej marrëdhëniet e privileguara ndërmjet Bashkimit Europian dhe Ballkanit Perëndimor dhe në të cilën Bashkimi Europian inkurajon vendet e rajonit të miratojnë një marrëveshje për tregun e energjisë në Europën Juglindore, të detyrueshme me ligj;*

*duke pasur parasysh Procesin e Partneritetit Euro-Mesdhetar dhe politikën europiane të fqinjësisë;*

*duke pasur parasysh kontributin e Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore, në thelb të të cilit është nevoja për të forcuar bashkëpunimin midis shteteve dhe kombeve të Europës Juglindore dhe për të krijuar kushtet për paqe, stabilitet dhe rritje ekonomike;*

*të vendosur për të krijuar ndërmjet palëve, një treg të integruar për gazin natyror dhe energjinë elektrike, bazur në interesin dhe solidaritetin e përbashkët;*

*duke menduar që ky treg i integruar mund të përfshijë, në një fazë të mëvonshme, të tjera produkte energjetike, si gazi natyror i lëngët, nafta, hidrogjeni, apo infrastruktura rrjeti të rëndësishme;*

*të vendosur për të krijuar një kuadër tregu rregullues dhe të qëndrueshëm, në gjendje për të tërhequr investime në rrjetet e gazit, prodhimin të energjisë dhe rrjeteve të transmetimit, në mënyrë që të gjitha palët të kenë akses në furnizimin e qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me gaz dhe energji elektrike, i cili është thelbësor për zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin social;*

*të vendosur për të krijuar një hapësirë të vetme rregullatore për tregtimin e gazit dhe energjisë elektrike, që është i nevojshëm për t'u përshtatur shtrirjes gjeografike të tregjeve të produkteve në fjalë;*

*duke pranuar që territoret e Republikës së Austrisë, Republikës së Greqisë, Republikës së Hungarisë, Republikës së Italisë dhe të Republikës së Sllovenisë janë të integruara natyrshëm ose të influencuara drejtpërdrejt nga funksionimi i tregut të gazit dhe energjisë elektrike të Palëve Kontraktuese;*

*të vendosur për të nxitur nivele të larta të furnizimit me gaz dhe energji elektrike për të gjithë qytetarët, bazuar në detyrimet e shërbimit publik, dhe për të arritur progres ekonomik dhe social, një nivel të lartë punësimi, si edhe një zhvillim të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm, përmes krijimit të një zone pa kufij të brendshëm për gazin dhe energjinë elektrike;*

*me dëshirën për të rritur sigurinë e furnizimit të hapësirës së vetme rregulluese nëpërmjet sigurimit të kuadrit të qëndrueshëm rregullues, i nevojshëm për rajonin ku mund të zhvillohen konjeksionet me rezervat e gazit në Kaspik, Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme, dhe mund të shfrytëzohen rezervat vendase të gazit natyror dhe qymyrit,*

*të angazhuar për të përmirësuar situatën mjedisore në lidhje me gazin dhe energjinë elektrike, efikasitetin përkatës të energjisë dhe burimeve të rinovueshme të energjisë;*

*të vendosur për të zhvilluar konkurrencën e tregut të gazit dhe energjisë elektrike në një shkallë të gjerë dhe shfrytëzuar ekonomitë e shkallës;*

*duke pasur parasysh që për të arritur këto qëllime, duhet të ngrihet një strukturë rregulluese e tregut, e plotë dhe e integruar, e mbështetur nga institucione të fuqishme dhe nga mbikëqyrja efikase, si dhe me përfshirjen e mjaftueshme të sektorit privat;*

<sup>1</sup> ["Republika e Turqisë" do të hiqet nëse Republika e Turqisë nuk do ta firmosë Traktatin]

<sup>2</sup> ["Republika e Turqisë" do të hiqet nëse Republika e Turqisë nuk do ta firmosë Traktatin]

duke pasur parasysh që, për të pakësuar stresin në sistemet e gazit dhe energjisë elektrike të niveleve shtetërore, dhe për të kontribuar në zgjidhjen e mangësive në gaz dhe energji elektrike në nivel lokal, duhet të krijohen rregulla specifike për të lehtësuar tregtimin e gazit dhe energjisë elektrike; dhe që këto rregulla nevojiten për të krijuar një hapësirë të vetme rregullatore për shtrirjen gjeografike të tregjeve të produkteve në fjalë,

kanë vendosur të krijojnë një Komunitet Energjie.

## KREU I PARIMET

### Neni 1

Përmes këtij Traktati, Palët krijojnë ndërmjet tyre një Komunitet të Energjisë.

Vendet anëtare të Komunitetit European mund të bëhen anëtare të Komunitetit të Energjisë, në bazë të nenit 95 të këtij Traktati.

### Neni 2

1. Detyra e Komunitetit të Energjisë do të jetë organizimi i marrëdhënieve ndërmjet Palëve dhe krijimi i kuadrit ligjor dhe ekonomik, në lidhje me rrjetin energjetik, si përcaktohen në paragrafin 2, me qëllim që të:

a) krijohet një kuadër i qëndrueshëm rregullues dhe i tregut, në gjendje që të tërheqë investime në rrjetet e gazit, prodhimin e energjisë dhe rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, në mënyrë që të gjitha palët të ketë akses në furnizimin e qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me energji, që është thelbësor për zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin social;

b) krijohet një hapësirë e vetme rregulluese për tregtinë e energjisë së rrjetit, e nevojshme për t'iu përshtatur shtrirjes gjeografike të tregjeve të produkteve në fjalë;

c) rritet siguria e furnizimit të hapësirë së vetme rregulluese nëpërmjet sigurimit të një klime të qëndrueshme investimesh, në të cilën mund të zhvillohen konjeksionet me rezervat e gazit në Kaspik, Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme, dhe mund të shfrytëzohen rezervat vendase të gazit natyror, qymyrit dhe hidroenergjetikës;

d) përmirësohet situata mjedisore në lidhje me energjinë e rrjetit dhe efikasitetin e energjisë, nxitet përdorimi i energjisë së rinovueshme, dhe të përcaktohen kushtet për tregtinë e energjisë në një hapësirë të vetme rregulluese;

e) zhvillohet konkurrenca e tregut të energjisë së rrjetit në një shkallë më të gjerë nga pikëpamja gjeografike dhe të shfrytëzohen ekonomitë e shkallës.

2. “Energjia e rrjetit” përfshin sektorët e energjisë elektrike dhe gazit, që përfshihen në direktivat 2003/54/EC dhe 2003/55/EC të Komunitetit European.<sup>3</sup>

### Neni 3

Për qëllimet e nenit 2, veprimtaria e Komunitetit të Energjisë përfshin:

a) implementimin nga ana e Palëve Kontraktuese të *acquis communautaire* për energjinë, mjedisin, konkurrencën dhe burimet e rinovueshme, siç përshkruhet në kreun II më poshtë, i përshtatur si me kuadrin institucional të Komunitetit të Energjisë, ashtu edhe situatës specifike të çdo Pale Kontraktuese (tani e tutje do të njihet si “Shtrirja e *acquis communautaire*”) siç dhe përshkruhet më tej në kreun II;

b) krijimin e një kuadri rregullues specifik që lejon funksionimin efikas të tregjeve të energjisë së rrjetit në territoret e Palëve Kontraktuese dhe në një pjesë të territorit të Komunitetit European, dhe përfshirjen e krijimit të një mekanizmi të vetëm për transmetimin ndërkufitar dhe/ose transportit të rrjetit të energjisë dhe mbikëqyrjen e masave të njëanshme mbrojtëse (tani e tutje do të njihet si “mekanizmi për funksionimin e tregjeve të rrjetit të energjisë”) siç edhe përshkruhet më tej në kreun III;

c) krijimin për Palët të një tregu të energjisë së rrjetit, pa kufij të brendshëm, duke përfshirë

<sup>3</sup> Direktiva 2003/54/EC e Parlamentit European dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2003, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, nr.L176e datës 15 korrik 2003, fq.37-56; dhe direktiva 2003/55/EC e Parlamentit European dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2003, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European nr.L176 e datës 15 korrik 2003, fq.57-78.

bashkërendimin e asistencës së ndërsjellë në rastet e çrregullimeve të rënda të rrjeteve të energjisë ose difekteve të jashtme, dhe që mund të përfshijë arritjen e një politike të përbashkët të jashtme për tregtinë e energjisë (tani e tutje do të njihet si “krijimi i një tregu të vetëm të energjisë”) siç edhe përshkruhet më tej në kreun IV.

#### Neni 4

Komisioni i Komuniteteve Europiane (tani e tutje do të përmendet si “Komisioni European”) do të veprojë si koordinator i tre veprimtarive të përshkruara në nenin 3.

#### Neni 5

Komuniteti i Energjisë do të zbatojë *acquis communautaire* të përshkruar në kreun II më poshtë, përshtatur me kuadrin institucional të këtij Traktati dhe situatën specifike të secilës prej Palëve Kontraktuese, me qëllim sigurimin e niveleve të larta të sigurisë së investimeve si dhe investimeve optimale.

#### Neni 6

Palët do të ndërmarrin të gjitha masat e duhura, në përgjithësi ose në veçanti, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky Traktat. Palët do të lehtësojnë realizimin e detyrave të Komunitetit të Energjisë. Palët do të heqin dorë nga çdo masë, e cila do të mund të vinte në rrezik arritjen e objektivave të këtij Traktati.

#### Neni 7

Ndalohet çdo diskriminim brenda fushës së veprimit të këtij Traktati.

#### Neni 8

Asgjë në këtë Traktat nuk do t’i prekë të drejtat e një Pale për të caktuar kushtet për shfrytëzimin e burimeve të saj të energjisë, zgjedhjen e saj ndërmjet burimeve të ndryshme të energjisë, si dhe strukturën e saj të përgjithshme të furnizimit me energji.

### KREU II SHTRIRJA E ACQUIS COMMUNAUTAIRE

#### KAPITULLI I SHTRIRJA GJEOGRAFIKE

#### Neni 9

Dispozitat dhe masat e parashikuara për t’u ndërmarrë brenda këtij kreu do të zbatohen në territoret e Palëve Aderuese dhe në territorin nën juridiksionin e Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

#### KAPITULLI II ACQUIS MBI ENERGJINË

#### Neni 10

Çdo Palë Kontraktuese do të implementojë *acquis communautaire* mbi energjinë në përputhje me afatet për implementimin e atyre masave, të parashtruara në shtojcën I.

#### Neni 11

11. “*Acquis communautaire* mbi energjinë”, për qëllime të këtij Traktati, do të thotë (i) Direktiva 2003/54/EC e Parlamentit European dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2003, në lidhje me rregullat e

përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, (ii) Direktiva 2003/55/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 26 qershor 2003 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe (iii) Rregullorja 1228/2003/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të datës 26 qershor 2003, mbi kushtet për aksesin në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.<sup>4</sup>

### KAPITULLI III ACQUIS MBI MJEDISIN

#### Neni 12

Çdo Palë Kontraktuese do të zbatojë *acquis communautaire* mbi mjedisin, në përputhje me afatet për zbatimin e atyre masave që janë parashtruar në shtojcën II.

#### Neni 13

Palët pranojnë rëndësinë e Protokollit të Kiotos. Çdo Palë Kontraktuese do të bëjë përpjekje për ta miratuar atë.

#### Neni 14

Palët pranojnë rëndësinë e rregullave të parashtruara në direktivën 96/61/EC të Këshillit Europian të 24 shtatorit 1996, lidhur me parandalimin e ndotjes së integruar dhe kontrollin. Çdo Palë Kontraktuese do të bëjë përpjekje për ta zbatuar atë Direktivë.

#### Neni 15

Pas hyrjes në fuqi të këtij Traktati, ndërtimi dhe shfrytëzimi i impianteve të rinj të prodhimit do të bëhet në përputhje me *acquis communautaire* mbi mjedisin.

#### Neni 16

16. “*Acquis communautaire* mbi mjedisin”, për qëllime të këtij Traktati do të thotë (i) Direktiva 1985/337/EEC e Këshillit, e datës 27 qershor 1985 “Mbi vlerësimin e ndikimeve mbi mjedisin të disa projekteve publike dhe private” siç është amenduar nga direktiva 97/11/EC e Këshillit e datës 3 mars 1997 dhe direktiva 2003/35/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 26 maj 2003, (ii) Direktiva 1999/32/EC e Këshillit e datës 26 prill 1999 “Mbi zvogëlimin në përmbajtje të squfurit tek disa lëndë djegëse të lëngshme dhe Direktiva amenduese 93/12/EEC; (iii) Direktiva 2001/80/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2001 “Mbi kufizimin e lëshimeve në ajër të disa ndotësve prej impianteve të mëdhenj me djegie dhe (iv) neni 4 (2) i Direktivës 79/409/EEC të Këshillit të datës 2 prill 1979 “Mbi ruajtjen e zogjve të egër”.

#### Neni 17

Dispozitat dhe masat e marra në këtë kapitull do të zbatohen vetëm për rrjetin e energjisë.

### KAPITULLI IV ACQUIS MBI KONKURRENCËN

#### Neni 18

1. Do të jenë të papajtueshme me funksionimin e duhur të këtij Traktati, të gjitha pikat e mëposhtme, përsa kohë që mund të prekin tregtinë e energjisë së rrjetit ndërmjet Palëve Kontraktuese:

a) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e shoqatave të sipërmarrjeve dhe praktikat e përbashkëta të cilat kanë si objekt të tyre ose influencojnë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës;

b) abuzimet prej një ose disa sipërmarrjeve me pozitë dominuese në tregun ndërmjet Palëve

<sup>4</sup> Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian nr.L 176 e datës 15 korrik 2003, fq.1-10.

Kontraktuese si një i tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tij,

c) çdo ndihmë publike e cila shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke favorizuar disa sipërmarrje ose burime të caktuara të energjisë.

2. Çdo praktikë që bie në kundërshtim me këtë nen do të vlerësohet në bazë të kritereve që dalin nga zbatimi i rregullave të neneve 81,82 dhe 87 të Traktatit, për krijimin e Komunitetit European (bashkëngjitur në shtojcën III).

#### Neni 19

Lidhur me sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet të cilave u janë dhënë të drejta të veçanta ose ekskluzive, çdo Palë Kontraktuese duhet të sigurojë që, 6 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Traktati, do të mbështeten parimet e traktatit për krijimin e Komunitetit European, në veçanti nenet 86 (1) dhe (2).

### KAPITULLI V ACQUIS PËR BURIMET E RINOVUESHME

#### Neni 20

Çdo Palë Kontraktuese duhet të paraqesë në Komisionin European, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij Traktati, një plan për implementimin e direktivës 2001/77/EC të Parlamentit European dhe Këshillit e datës 27 shtator 2001 “Mbi nxitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme në tregun e brendshëm të energjisë” dhe Direktivën 2003/30/EC të Parlamentit European dhe Këshillit e datës 8 maj 2003 “Mbi nxitjen e përdorimit të biokarburanteve ose karburanteve të tjera të rinovueshme për transport”. Komisioni European do t’ia paraqesë për miratim planin e çdo Pale Kontraktuese, Këshillit Ministeror.

### KAPITULLI VI PAJTUESHMËRIA ME STANDARDET PËRGJITHËSISHT TË ZBATUESHME TË KOMUNITETIT EUROPIAN

#### Neni 21

Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij Traktati, Sekretariati duhet të hartojë një listë të standardeve përgjithësisht të zbatueshme të Komunitetit European, që do t’i paraqiten për miratim Këshillit Ministeror.

#### Neni 22

Palët Kontraktuese, brenda një viti nga miratimi i listës, duhet të miratojnë plane zhvillimi për të sjellë sektorët e tyre të energjisë të rrjetit në një linjë me standardet përgjithësisht të zbatueshme të Komunitetit European.

#### Neni 23

“Standardet përgjithësisht të zbatueshme të Komunitetit European” i referohen çdo standardi të sistemit teknik, i cili zbatohet brenda Komunitetit European dhe është i nevojshëm për të shfrytëzuar në mënyrë të sigurt dhe efikase sistemet e rrjetit, përfshirë aspektet e transmetimit, konjeksionet ndërkufitare, rregullimet dhe standardet e përgjithshme të sigurisë të sistemeve teknike, të nxjerra aty ku janë të zbatueshme përmes Komunitetit European për standardizimin (CEN), Komitetit European për standardizimin elektronik (CENELEC) dhe energjinë elektrike (UCTE) dhe Shoqatës Europiane për efikasitetin e shkëmbimeve energjetike (Easeegas) për vendosjen e rregullave të përbashkëta dhe praktikat e punës.

### KAPITULL VII PËRSHTATJA DHE ZHVILLIMI I ACQUIS

#### Neni 24

Për implementimin e këtij kreu, Komuniteti i Energjisë do të miratojë masat për të përshtatur *acquis communautaire* të përshkruar tek ky kre, duke marrë parasysh si kuadrin institucional të këtij Traktati, ashtu edhe situatën specifike të secilës Palë Kontraktuese.

#### Neni 25

Komuniteti i Energjisë mund të marrë masa për të implementuar amendimet e *acquis communautaire* të përshkruara në këtë kre, në përputhje me zhvillimin e ligjeve të Komunitetit Europian.

### KREU III MEKANIZMA E OPERIMIT TË TREGJEVE TË ENERGJISË SË RRJETIT

#### KAPITULLI I SHTRIRJA GJEOGRAFIKE

#### Neni 26

Dispozitat dhe masat e parashikuara në këtë kre do të zbatohen në territoret e Palëve Aderuese, në territorin nën juridiksionin e Misionit të Përkohshëm Qeverisës të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe në territoret e shteteve të Komunitetit Europian, të cilave u referohet neni 27.

#### Neni 27

Përsa i përket Komunitetit Europian, dispozitat dhe masat që parashikohen në këtë kre, do të zbatohen në territorin e Republikës së Austrisë, të Republikës së Greqisë, të Republikës së Hungarisë, Republikës së Italisë dhe Republikës së Sllovenisë. Me hyrjen në Bashkimin Europian të një Pale Aderuese, dispozitat e këtij kreu dhe masat e parashikuara sipas këtij kreu do të zbatohen, pa formalitete të mëtejshme, edhe në territorin e atij shteti të ri anëtar.

### KAPITULLI II MEKANIZMI PËR TRANSPORTIN NË DISTANCA TË GJATA TË ENERGJISË SË RRJETIT

#### Neni 28

Komuniteti i Energjisë do të marrë masa shtesë për të krijuar një mekanizëm për transmetimin dhe/ose transportin ndërkufitar të energjisë së rrjetit.

### KAPITULLI III SIGURIA E FURNIZIMIT

#### Neni 29

Palët, brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi së këtij Traktati, duhet të miratojnë deklaratimet për sigurimin e rezervave duke parashikuar në mënyrë të veçantë diversitetin e furnizimit, sigurimin teknologjik dhe origjinën gjeografike të lëndëve djegëse të importuara. Këto deklaratime do t'i komunikohen Sekretariatit, dhe do të jenë në dispozicion të çdo Pale në këtë Traktat. Ato do të azhurnohen çdo dy vjet. Sekretariati do të japë udhëzime dhe asistencë në lidhje me këto deklaratime.

#### Neni 30

Neni 29 nuk nënkupton domosdoshmërinë e ndryshimit të politikave energjetike apo praktikave të blerjes.

## KAPITULLI IV FURNIZIMI I QYTETARËVE ME ENERGJI

### Neni 31

Komuniteti European do të nxisë nivele të larta të furnizimit me energji rrjeti për të gjithë qytetarët, brenda kufijve të detyrimeve të sektorit publik, që përmbahen në sektorin përkatës të *acquis communautaire* mbi energjinë.

### Neni 32

Për këtë qëllim, Komuniteti i Energjisë mund të marrë masa për të:

- a) lejuar furnizimin universal me energji elektrike;
- b) nxitur politika efikase të menaxhimit të kërkesës;
- c) garantuar konkurrencë të drejtë.

### Neni 33

Komuniteti i Energjisë mund të bëjë rekomandime për të mbështetur reforma efikase të sektorëve të energjisë së rrjetit të Palëve, duke përfshirë, ndër të tjera, rritjen e nivelit të pagesës për energjinë nga të gjithë klientët, dhe të kujdeset për përballimin e çmimeve të energjisë nga të gjithë blerësit.

## KAPITULLI V HARMONIZIMI

### Neni 34

Komuniteti i Energjisë mund të marrë masa lidhur me pajtueshmërinë e modeleve të tregut, për funksionimin e tregut të energjisë së rrjetit, si dhe njohjen reciproke të licencave dhe masat që duhen marrë për krijimin e lirë të kompanive të energjisë së rrjetit.

## KAPITULLI VI BURIMET E ENERGJISË SË RINOVUESHME DHE EFIÇENCA E ENERGJISË

### Neni 35

Komuniteti i Energjisë mund të miratojë masa për t'u kujdesur për zhvillimin në fushat e burimeve të energjisë së rinovueshme dhe efiçencën e energjisë, duke marrë parasysh avantazhet që ato kanë në drejtim të sigurisë së furnizimit, mbrojtjes së mjedisit, kohezionit social dhe zhvillimit rajonal.

## KAPITULLI VII MASAT MBROJTËSE

### Neni 36

Në rast të një krize të papritur në tregun e energjisë së rrjetit në territorin e një Pale Aderuese, territorin nën juridiksionin e Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, ose territorin e Komunitetit European, të cilit i referohet neni 27, ku mbrojtja fizike ose siguri i personave apo pajisjeve, instalimeve ose integritetit të sistemit të rrjetit energjetik kërcënohet brenda këtij territori, Pala përkatëse mund të marrë masat e përkohshme të nevojshme mbrojtëse.

### Neni 37

Këto masa mbrojtëse do të shkaktojnë sa më pak çrregullime që të jetë e mundur në funksionimin e tregut të rrjetit energjetik të Palëve, dhe të mos kenë një shtrirje më të gjerë nga ç'është e nevojshme për të ndrequr vështirësitë e papritura që kanë dalë. Ato nuk do të shtrembërojnë konkurrencën ose të dëmtojnë tregun, në një mënyrë e cila bie ndesh me interesin e përbashkët.

#### Neni 38

Pala e interesuar do të njoftojë pa vonuar Sekretariatit në lidhje me këto masa mbrojtëse, i cili duhet t'i informojë menjëherë Palët e tjera.

#### Neni 39

Komuniteti i Energjisë mund të vendosë që masat mbrojtëse të marra nga Pala e interesuar nuk pajtohen me dispozitat e këtij kapitulli, dhe t'i kërkojë kësaj Pale t'u japë fund ose modifikojë ato masa mbrojtëse.

### KREU IV KRIJIMI I NJË TREGU TË VETËM TË ENERGJISË

#### KAPITULLI I SHTRIRJA GJEOGRAFIKE

#### Neni 40

Dispozitat dhe masat e marra sipas këtij kreu do të zbatohen në ato territore ku Traktati që krijon Komunitetin European zbatohet sipas kushteve të parashtruara në atë Traktat, në territoret e Palëve Aderuese dhe në territorin që është nën juridiksionin e Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

#### KAPITULLI II TREGU I BRENDSHËM I ENERGJISË

#### Neni 41

1. Do të ndalohen, ndërmjet Palëve, taksat doganore dhe kufizimet sasiore mbi importin dhe eksportin e energjisë dhe të gjitha masat që kanë efekt të njëjtë. Ky ndalim do të zbatohet edhe për tarifatat doganore të një natyre fiskale.

2. Paragrafi I nuk parandalon kufizimet sasiore ose masat që kanë efekt të njëjtë, që justifikohen nga politika publike ose siguria publike; mbrojtja e shëndetit dhe jetës së njeriut, kafshëve apo impianteve, ose mbrojtja e pronës industriale dhe tregtare. Megjithatë, këto kufizime ose masa nuk do të jenë mjete të diskriminimit arbitrar ose kufizimit të maskuar për tregtinë mes Palëve.

#### Neni 42

1. Komuniteti i Energjisë mund të marrë masa me synim që të krijojë një treg të vetëm, pa kufij të brendshëm për energjinë e rrjetit.

2. Paragrafi I nuk do të zbatohet për masat fiskale, për ato masa që kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të njerëzve dhe as për ato që lidhen me të drejtat dhe interesat e personave të punësuar.

#### KAPITULLI III POLITIKAT E TREGTISË SË JASHTME TË ENERGJISË

#### Neni 43

Komuniteti i Energjisë mund të marrë masa që janë të nevojshme për rregullimin e importeve dhe eksporteve të energjisë së rrjetit, drejt dhe nga vendet e treta, me pikësynim që të sigurojë akses të njëjtë drejt dhe nga tregjet e vendeve të treta, në lidhje me standardet themelore të mjedisit ose për të siguruar funksionimin e sigurt të tregut të brendshëm të energjisë.

#### KAPITULLI IV NDIHMA E NDËRSJELLË NË RAST ÇRREGULLIMI

#### Neni 44

Në rast çrregullimi në furnizimin e rrjetit energjetik që dëmton një Palë dhe që përfshin një Palë

tjetër ose një vend të tretë, Palët do të kërkojnë një zgjidhje të shpejtë, në përputhje me dispozitat e këtij kapitulli.

#### Neni 45

Me kërkesë të Palës së prekur direkt nga çrregullimi, do të mbledhet Këshilli Ministeror. Këshilli i Ministrave mund të marrë masat e nevojshme duke reaguar ndaj çrregullimit.

#### Neni 46

Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij Traktati, Këshilli Ministeror do të miratojë një akt procedural për funksionimin e detyrimit të ndihmës së ndërsjellë sipas këtij kapitulli, i cili mund të përfshijë delegim të kompetencave Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë për të marrë masa të përkohshme.

### KREU V INSTITUCIONET E KOMUNITETIT TË ENERGJISË

#### KAPITULLI I KËSHILLI MINISTEROR

#### Neni 47

Këshilli Ministeror do të sigurojë që objektivat e vendosura nga ky Traktat, do të arrihen. Ai do të:

- a) japë udhëzime të politikave të përgjithshme;
- b) marrë masa;
- c) miratojë akte procedurale, që mund të përfshijnë delegimin sipas kushteve të përpikta, të detyrave, të drejtave dhe detyrimeve specifike për të zbatuar politikën e Komunitetit të Energjisë, Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë, Bordit Rregullator ose Sekretariatit.

#### Neni 48

Këshilli Ministeror do të përbëhet nga një përfaqësues prej çdo Pale Kontraktuese dhe dy përfaqësues nga Komuniteti European. Në takime mund të marrin pjesë nga një përfaqësues pa të drejtë vote prej çdo pjesëmarrësi.

#### Neni 49

Këshilli Ministeror do të miratojë rregullat e brendshme të procedurës me anë të aktit procedural.

#### Neni 50

Presidenca do të mbahet me radhë nga çdo Palë Kontraktuese për një mandat 6-muajsh, sipas një radhe që vendoset me akt procedural prej Këshillit Ministeror. Presidenca thërret mbledhjen e Këshillit Ministeror në një vend të caktuar nga Presidenca. Këshilli Ministeror do të mbledhet të paktën një herë në çdo 6 muaj. Takimet përgatiten nga Sekretariati.

#### Neni 51

Presidenca drejton Këshillin Ministeror dhe asistohet nga një përfaqësues i Komunitetit European dhe nga një përfaqësues i presidencës së radhës, si zëvendëspresidentë. Presidenca dhe zëvendëspresidentët përgatisin draftin e axhendës.

## Neni 52

Këshilli Ministeror do t'u paraqesë Parlamentit European dhe Parlamenteve të Palëve Aderuese dhe pjesëmarrësve një raport vjetor të veprimtarisë së Komunitetit të Energjisë.

## KAPITULLI II GRUPI I PËRHERSHËM I NIVELIT TË LARTË

## Neni 53

Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë do të:

- a) përgatisë punën e Këshillit Ministeror;
- b) japë miratim për kërkesat për asistencë teknike të bëra nga donatorët ndërkombëtarë, institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët dypalësh;
- c) raportojë në Këshillin Ministeror lidhur me ecurinë e arritjes së objektivave të këtij Traktati;
- d) marrë masa, nëse kjo e drejtë i është deleguar nga Këshilli Ministeror;
- e) miratojë aktet procedurale, ku nuk përfshihet delegimi i detyrave, të drejtave apo detyrimeve mbi institucione të tjera të Komunitetit të Energjisë;
- f) diskutojë zhvillimin e *acquis communautaire* të përshkruar në kreun II, në bazë të një raporti të cilin do ta paraqesë rregullisht Komisioni European.

## Neni 54

Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë do të përbëhet nga një përfaqësues i çdo Pale Kontraktuese dhe dy përfaqësues të Komunitetit European. Në takimet e tij mund të marrin pjesë nga një përfaqësues pa të drejtë vote prej çdo pjesëmarrësi.

## Neni 55

Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë do të miratojë rregullat e tij të brendshme të procedurës me anë të aktit procedural.

## Neni 56

Presidenca do të thërrasë mbledhjen e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë në një vend që caktohet nga Presidenca. Mbledhjet do të përgatiten nga Sekretariati.

## Neni 57

Presidenca do të drejtojë Grupin e Përhershëm të Nivelit të Lartë dhe do të asistohet nga një përfaqësues i Komunitetit European dhe një përfaqësues i Presidencës së ardhshme si zëvendëspresidentë. Presidenca dhe zëvendëspresidentët do të përgatisin draftin e axhendës.

## KAPITULLI III BORDI RREGULLATOR

## Neni 58

Bordi Rregullator do të:

- a) informojë Këshillin Ministeror ose Grupin e Përhershëm të Nivelit të Lartë në lidhje me detajet e rregullave statutore, teknike dhe rregullatore;
- b) japë rekomandime në lidhje me mosmarrëveshje ndërkufitare që përfshijnë dy ose më shumë rregullatorë, me kërkesë të çdo njërit prej tyre;
- c) marrë masa, nëse autorizohet nga Këshilli Ministeror;
- d) miratojë akte procedurale.

#### Neni 59

Bordi Rregullator do të përbëhet nga një përfaqësues i rregullatorit të energjisë të çdo Pale Kontraktuese, sipas pjesëve përkatëse të *acquis communautaire* për energjinë. Komuniteti European do të përfaqësohet nga Komisioni European, i asistuar nga një rregullator i çdo pjesëmarrësi dhe një përfaqësues i Grupit European të Rregullatorëve për Energjinë Elektrike dhe Gazin (ERGEG). Nëse një Palë Kontraktuese ose një anëtar ka një rregullator për gazin dhe një për energjinë elektrike, Pala Kontraktuese ose anëtari përcaktojnë se cili rregullator do të marrë pjesë në një takim të Bordit Rregullator, duke marrë parasysh axhendën e takimit.

#### Neni 60

Bordi Rregullator miraton rregullat e tij të brendshme të procedurës me akt procedural.

#### Neni 61

Bordi Rregullator zgjedh një president për një mandat që përcaktohet nga Bordi Rregullator. Komisioni European do të veprojë si zëvendëspresident. Presidenti dhe zëvendëspresidenti përgatisin draftin e axhendës.

#### Neni 62

Bordi Rregullator mblidhet në Athinë.

### KAPITULLI IV FORUMET

#### Neni 63

Dy forume, të përbëra nga të gjithë aktorët e interesuar duke përfshirë industrinë, rregullatorët, grupet përfaqësuese të industrisë dhe konsumatorët këshillojnë Komunitetin e Energjisë.

#### Neni 64

Forumet do të drejtohen nga një përfaqësues i Komunitetit European.

#### Neni 65

Konkluzionet e forumeve do të miratohen me konsensus. Ato do t'i përcillen Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë.

#### Neni 66

Forumi i energjisë elektrike do të mblidhet në Athinë. Forumi i gazit do të mblidhet në Stamboll.<sup>5</sup>

### KAPITULLI V SEKRETARIATI

#### Neni 67

Sekretariati:

a) i siguron mbështetje administrative Këshilli Ministeror, Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë, Bordit Rregullator dhe forumeve;

---

<sup>5</sup>[ Nëse Turqia nuk do ta firmosë Traktatin, neni 66 do të zëvendësohet si vijon: “Forumi i energjisë elektrike do të mblidhet në Athinë. Forumi i gazit do të mblidhet në një vend që do të caktohet me një akt procedural të Këshillit Ministeror”.]

b) shqyrton implementimin e duhur nga ana e Palëve të detyrimeve këtyre në këtë Traktat dhe i dërgon Këshillit Ministeror raporte vjetore të ecurisë;

c) shqyrton dhe asiston në koordinimin nga ana e Komisionit European të veprimtarisë së donatorëve në territoret e Palëve Aderuese dhe territorin nën juridiksionin e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, si dhe ofron mbështetje administrative për donatorët;

d) kryen detyrat që i janë caktuar në Traktat ose nga një akt procedural i Këshillit Ministeror, duke përjashtuar kompetencën për të marrë masa;

e) miraton akte procedurale.

Neni 68

Sekretariati përbëhet nga një drejtor dhe aq staf sa do të kërkojë Komuniteti i Energjisë.

Neni 69

Drejtori i Sekretariatit emërohet me akt procedural të Këshillit Ministeror. Këshilli Ministeror do të parashtojë, me akt procedural, rregullat për rekrutimin, kushtet e punës dhe balancimin gjeografik të stafit të Sekretariatit. Drejtori përzgjedh dhe emëron stafin.

Neni 70

Në kryerjen e detyrave të tyre, drejtori dhe stafi nuk kërkojnë apo marrin udhëzime nga ndonjë palë e këtij Traktati. Ata veprojnë me paanshmëri dhe përkrahin interesin e Komunitetit të Energjisë.

Neni 71

Drejtori i Sekretariatit ose një zëvendës i emëruar asiston në Këshillin Ministeror, Grupin e Përhershëm të Nivelit të Lartë, Bordin Rregullator dhe forumet.

Neni 72

Selia e Sekretariatit është në Vjenë.

## KAPITULLI VI BUXHETI

Neni 73

Çdo Palë kontribuon në buxhetin e Komunitetit të Energjisë si përcaktohet në shtojcën IV. Nivelin e kontributeve mund të rishikohet çdo pesë vjet, me kërkesë të cilësdo Palë, me anë të një akti procedural të Këshillit Ministeror.

Neni 74

Këshilli Ministeror miraton buxhetin e Komunitetit European, me akt procedural, çdo dy vjet. Buxheti mbulon shpenzimet e funksionimit të Komunitetit të Energjisë që janë të nevojshme për funksionimin e institucioneve të tij. Shpenzimet për secilin institucion do të parashtrohen në një pjesë të ndryshme të buxhetit. Këshilli Ministeror miraton një akt procedural që specifikon procedurën për implementimin e buxhetit dhe për paraqitjen dhe auditimin e llogarive si dhe inspektimin.

Neni 75

Drejtori i Sekretariatit implementon buxhetin në përputhje me aktin procedural, të miratuar sipas neni 74, dhe i raporton çdo vit Këshillit Ministeror mbi zbatimin e buxhetit. Këshilli Ministeror, me akt procedural, mund të vendosë nëse duhet t'u besojë revizorëve të pavarur verifikimin e zbatimit të duhur të buxhetit.

KREU VI  
PROCESI I VENDIMMARRJES

KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 76

Masat mund të marrin formën e një vendimi ose rekomandimi.  
Një vendim është ligjërisht detyrues në tërësinë e tij, për të gjithë ata të cilëve u drejtohet.  
Një rekomandim nuk ka forcë detyruese. Palët do të bënë përpjekje maksimale për të realizuar rekomandimet.

Neni 77

Sipas dispozitave të nenit 80, secila Palë ka të drejtën e një vote.

Neni 78

Këshilli Ministeror, Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë ose Bordi Rregullator mund të veprojnë vetëm nëse dy të tretat e Palëve janë të përfaqësuar. Abstenimet në votime nga Palët e pranishme nuk do të llogariten si vota të hedhura.

KAPITULLI II  
MASAT SIPAS KREUT II

Neni 79

Këshilli i Ministrave, Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë ose Bordi Rregullator do të marrin masa sipas kreut II, me një propozim nga Komisioni European. Komisioni European mund të ndryshojë ose tërheqë në çdo moment propozimin e tij, gjatë zhvillimit të procedurave për miratimin e masave.

Neni 80

Secila Palë Kontraktuese ka të drejtën e një vote.

Neni 81

Këshilli i Ministrave, Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë dhe Bordi Rregullator do të veprojnë në bazë të shumicës së votave.

KAPITULLI III  
MASAT SIPAS KREUT III

Neni 82

Këshilli Ministeror, Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë ose Bordi Rregullator do të marrin masa sipas kreut III, me propozimet e një Pale ose Sekretariatit.

Neni 83

Këshilli Ministeror, Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë ose Bordi Rregullator do të veprojnë në bazë të shumicës me dy të tretën e votave, duke përfshirë një votë pro të Bashkimit European.

KAPITULLI IV  
MASAT SIPAS KREUT IV

#### Neni 84

Këshilli Ministeror, Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë ose Bordi Rregullator do të marrin masa sipas kreut IV, me propozimin e një Pale.

#### Neni 85

Këshilli Ministeror, Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë ose Bordi Rregullator do të marrin masa në mënyrë unanime.

### KAPITULLI V AKTET PROCEDURALE

#### Neni 86

Një akt procedural rregullon çështjet organizative, buxhetore dhe të transparencës të Komunitetit të Energjisë, përfshirë delegimin e kompetencave nga Këshilli Ministeror për te Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë, Bordi Rregullator ose Sekretariati, dhe ka forcë detyruese mbi institucionet e Komunitetit të Energjisë dhe, nëse e parashikon akti procedural, edhe mbi Palët.

#### Neni 87

Në bazë të dispozitave të nenit 88, aktet procedurale do të miratohen në përputhje me procesin e vendimmarrjes, të përcaktuar në kapitullin III të këtij kreu.

#### Neni 88

Akti procedural që emëron drejtorin e Sekretariatit, i parashikuar në nenin 69 miratohet me shumicë të thjeshtë me propozim të Komisionit European. Aktet procedurale mbi çështjet buxhetore, të parashikuara në nenet 73 dhe 74 miratohen me unanimitet, me një propozim të Komisionit European. Aktet procedurale që i akordojnë të drejta Bordit Rregullator të parashikuar në nenin 47 (c) do të merren me unanimitet me një propozim të një Pale ose Sekretariatit.

### KREU VII IMPLEMENTIMI I VENDIMEVE DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

#### Neni 89

Palët do të implementojnë vendimet, të cilat u drejtohen atyre me anë të legjislacionit të brendshëm, brenda periudhës kohore të përcaktuar në vendim.

#### Neni 90

Në rast moszbatimi nga cilado Palë e një detyrimi që rrjedh nga Traktati ose moszbatimi të vendimeve, të cilat i drejtohen cilësdo Palë, brenda afatit kohor të caktuar, do të vihet në dijeni Këshilli Ministeror, me kërkesë të arsyetuar të cilësdo Palë, Sekretariatit apo Bordit Rregullator. Organizma privatë mund t'i drejtohen Sekretariatit me ankesa.

Pala në fjalë mund të bëjë vëzhgime në përgjigje të kërkesës apo ankesës.

#### Neni 91

Këshilli Ministeror mund të vendosë për ekzistencën e një shkeljeje nga një Palë të detyrimeve të saj. Këshilli Ministeror vendos:

- a) me shumicë të thjeshtë, nëse shkelja ka të bëjë me kreun II;
- b) me shumicë me dy të tretat, nëse shkelja ka të bëjë me kreun III;
- c) me unanimitet, nëse shkelja ka të bëjë me kreun IV.

Pas kësaj, Këshilli Ministeror mund të vendosë me shumicë të thjeshtë për të revokuar çdo vendim

të marrë sipas këtij neni.

#### Neni 92

Me kërkesë të një Pale, Sekretariati ose Bordi Rregullator, Këshilli Ministeror mund të vendosë me unanimitet për ekzistencën e një shkeljeje të rëndë dhe të vazhdueshme nga një Palë të detyrimeve që rrjedhin nga Traktati dhe mund të pezullojë të drejtat që rrjedhin nga Traktati dhe mund të pezullojë të drejtat që rrjedhin nga ky Traktat për Palën shkelëse, duke përfshirë pezullimin e së drejtës së votës dhe përjashtim nga mbledhjet ose mekanizmat e parashikuar në këtë Traktat.

Pas kësaj, Këshilli Ministeror mund të vendosë me shumicë të thjeshtë për të revokuar çdo vendim të marrë sipas këtij neni.

#### Neni 93

Kur miraton vendimet e parashikuara në nenet 91 dhe 92, Këshilli Ministeror do të vendosë pa marrë parasysh votën e Palës shkelëse.

### KREU VIII INTERPRETIMI

#### Neni 94

Institucionet do të interpretojnë çdo term apo koncept tjetër të përdorur në këtë Traktat që rrjedh nga ligji i Komunitetit European, në përputhje me precedentët ligjorë të Gjykatës së Drejtësisë ose Gjykatës së Shkallës së Parë të Komuniteteve Europiane. Atje ku interpretimi nga këto gjykata nuk është i disponueshën, Këshilli Ministeror do të ofrojë udhëzime në interpretimin e këtij Traktati. Ai mund t'ia delegojë këtë detyrë Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë. Këto udhëzime nuk mund të bien ndesh me ndonjë interpretim të *acquis communautaire* nga ana e Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykata e Shkallës së Parë.

### KREU IX PJESËMARRËSIT DHE VËZHGUESIT

#### Neni 95

Me anë të një kërkesë në Këshillin Ministeror, çdo vend anëtar i Bashkimit European mund të përfaqësohet në Këshillin Ministeror, Grupin e Përhershëm të Nivelit të Lartë dhe në Bordin Rregullator, sipas kushteve të nenit 48, 54 dhe 59 në cilësinë e pjesëmarrësit dhe lejohet të marrë pjesë në diskutimet e Këshillit Ministeror, Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë, Bordit Rregullator dhe forumeve.

#### Neni 96

Me kërkesë të një shteti të tretë fqinjë, Këshilli Ministeror mund ta pranojë me unanimitet atë shtet si vëzhgues. Në bazë të një kërkesë të paraqitur në Këshillin Ministeror brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Traktati, Moldavia do të pranohet si vend vëzhgues.

Vëzhguesit mund të marrin pjesë në takimet e Këshillit Ministeror, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë, Bordit Rregullator dhe forumeve, pa marrë pjesë në diskutime.

### KREU X KOHËZGJATJA

#### Neni 97

Ky Traktat përfundon 10 vjet nga data e hyrjes në fuqi të tij. Këshilli Ministeror, mund të vendosë me unanimitet rritjen e kohëzgjatjes së tij. Nëse nuk merret një vendim i tillë, Traktati mund të vazhdojë të zbatohet ndërmjet atyre Palëve që kanë votuar pro zgjatjes, me kusht që numri i tyre të jetë të paktën sa dy të tretat e Palëve të Komunitetit të Energjisë.

#### Neni 98

Secila nga Palët mund të tërhiqet nga ky Traktat duke bërë një njoftim drejtuar Sekretariatit gjashtë muaj përpara.

#### Neni 99

Me hyrjen në Komunitetin European të një Pale Aderuese, ajo Palë do të bëhet pjesëmarrëse, siç parashikohet në nenin 95.

### KREU XI RISHIKIMI DHE HYRJA

#### Neni 100

Këshilli Ministeror, me unanimitet mund të:

- i) amendojë dispozitat e kreut I-VII;
- ii) vendosë të implementojë pjesët e tjera të *acquis communautaire* që kanë të bëjnë me energjinë e rrjetit;
- iii) zgjerojë këtë Traktat për produkte të tjera energjetike ose infrastruktura të tjera thelbësore të rrjetit;
- iv) miratojë hyrjen në Komunitetin e Energjisë të një Pale të re.

### KREU XII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE TË PËRKOHSHME

#### Neni 101

Pa rënë ndesh me nenet 102 dhe 103, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e lidhura nga një Palë përpara nënshkrimit të këtij Traktati, nuk do të preken nga dispozitat e këtij Traktati. Në rast se këto marrëveshje nuk do të jenë të pajtueshme me Traktatin, Pala Kontraktuese do të marrë të gjitha masat e duhura për eliminimin e mospajtueshmërisë, jo më vonë se një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Traktati.

#### Neni 102

Të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ky Traktat nuk bien ndesh me detyrimet ekzistuese ligjore të palëve që kanë firmosur Traktatin e Organizatës Botërore të Tregtisë.

#### Neni 103

Çdo detyrim që rrjedh nga një marrëveshje ndërmjet Bashkimit European dhe vendeve anëtare të tij nga njëra anë, dhe një Pale Kontraktuese nga ana tjetër, nuk do të cenohet nga ky Traktat. Çdo angazhim i marrë në kuadër të negociatave për hyrjen në Bashkimin European nuk do të cenohet nga ky Traktat.

#### Neni 104

Deri në miratimin e aktit procedural për të cilin bën fjalë neni 50, memorandum i mirëkuptimit i Athinës 2003 do të përcaktojë radhën e mbajtjes së Presidencës.<sup>6</sup>

#### Neni 105

Ky Traktat do të miratohet nga Palët në përputhje me procedurat e secilit vend.

---

<sup>6</sup> Memorandumi i mirëkuptimit mbi tregun rajonal të energjisë në Europën Juglindore dhe i Integritimit të tij në tregun e brendshëm të energjisë të Komunitetit European, firmosur në Athinë, në 8 dhjetor 2003.

Ky Traktat do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas datës në të cilën Bashkimi Europian dhe gjashtë Palë Kontraktuese kanë njoftuar për përfundimin e procedurave të nevojshme për këtë qëllim.

Njoftimi do t'i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Bashkimit Europian, i cili do të jetë depozituesi i këtij Traktati.

#### SHTOJCË I

##### KALENDARI PËR IMPLEMENTIMIN E DIREKTIVAVE NR.2003/54 DHE 2003/55 DHE RREGULLORES SË KE NR.1228/2003 TË DATËS 26 QERSHOR 2003

1. Në përputhje me paragrafin 2 më poshtë dhe nenin 24, secila Palë Kontraktuese do të implementojë, brenda dymbëdhjetë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij Traktati:

i) Direktivën 2003/54/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 26 qershor 2003, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike;

ii) Direktivën 2003/55/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 26 qershor 2003, në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror;

iii) Rregulloren 1228/2003/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 26 qershor 2003, në lidhje me kushtet për akses në rrjetin e shkëmbimeve ndërkufitare të energjisë elektrike.

3. Secila Palë Kontraktuese duhet të sigurohet që klientë të kualifikuar brenda kuadrit të Direktivave të Komunitetit Europian 2003/54/EC dhe 2003/55/EC do të jenë:

i) Nga 1 janari 2008, të gjithë konsumatorët jofamiljarë;

ii) nga 1 janari 2015 të gjithë konsumatorët.

#### SHTOJCË II

##### KALENDARI PËR IMPLEMENTIMIN E ACQUIS MBI MJEDISIN

1. Secila Palë Kontraktuese, me hyrjen në fuqi të këtij Traktati, do të implementojë direktivën 85/33/EC të Këshillit, të datës 27 qershor 1985 “Mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin”, siç është amenduar nga Direktivat e Këshillit 97/11/EC datë 3 mars 1997 dhe Direktiva 2003/35/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 26 maj 2003.

2. Secila Palë Kontraktuese do të implementojë deri në 31 dhjetor 2011, Direktivën 1999/32/EC të Këshillit të datës 26 prill 1999 në lidhje me “Një reduktim në përmbajtjen e squfurit tek disa lëndë të djegshme të lëngshme” dhe Direktivën amenduese 93/12/EEC.

3. Secila Palë Kontraktuese do të implementojë, deri më 31 dhjetor 2017, Direktivën 2001/80/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 23 tetor 2001 “Mbi kufizimin e lëshimeve të disa ndotësve në ajër, nga impiantet e mëdhenj me lëndë djegëse”.

4. Secila Palë Kontraktuese do të implementojë, me hyrjen në fuqi të këtij Traktati, neni 4 (2) të Direktivës 79/409/EEC të Këshillit të datës 2 prill 1979 “Mbi ruajtjen e zogjve të egër”.

#### SHTOJCA III

##### NENI 81 I TRAKTATIT TË KE-SË

1. Do të ndalohen si të papajtueshme me tregun e përbashkët: të gjitha marrëveshjet mes sipërmarrjeve, vendimet nga shoqata sipërmarrjesh dhe praktika të bashkërenduara, të cilat mund të dëmtojnë tregtinë mes shteteve anëtare dhe që kanë si objekt apo efekt të tyre, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës brenda tregut të përbashkët, në mënyrë të veçantë, ato që:

a) fiksojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi çmimet e blerjes apo shitjes apo kushte të tjera të tregtisë;

b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;

c) ndajnë tregje ose burime furnizimi;

d) zbatojnë kushte të pabarabarta për transaksione të njëjta me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato kështu në disavantazh konkurrues;

e) konkludojnë kontrata ku palët e tjera pranojnë detyrime shtesë që, nga natyra ose për nga përdorimi komercial, nuk kanë lidhje me qëllimin e këtyre kontratave.

2. Çdo marrëveshje ose vendim i ndaluar sipas këtij neni do të jetë automatikisht i anuluar.

3. Megjithatë, dispozitat e paragrafit 1 do të shpallen të pazbatueshme në rastet kur:

- çdo marrëveshje apo kategori marrëveshjesh mes sipërmarrjeve,

- çdo vendim apo kategori vendimesh mes sipërmarrjeve,

- çdo praktikë e bashkërenduar apo kategori praktikash të bashkërenduara

kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjes së mallrave ose nxitjen e progresit ekonomik, ndërkohë që u lejon të gjithë konsumatorëve një ndarje të drejtë të përfitimeve që rezultojnë nga kjo, dhe që nuk:

a) nuk u imponon sipërmarrjeve kufizime të bashkërenduara të cilat nuk janë të domosdoshme për arritjen e objektivave;

b) u lejon këtyre sipërmarrjeve mundësinë e eliminimit të konkurrencës, në lidhje me një pjesë të rëndësishme të produktit në fjalë.

#### Neni 82 i Traktatit të KE-së

Çdo abuzim nga një ose më shumë sipërmarrje me pozicionin dominues brenda tregut të përbashkët ose në një pjesë domethënëse të tij do të ndalohet si e papajtueshme me tregun e përbashkët, për aq sa ajo do të dëmtojë tregtinë mes shteteve anëtare.

Një abuzim i tillë, në mënyrë të veçantë mund të konsistojë në:

a) imponim drejtpërdrejtë ose tërthorazi të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo kushteve të tjera të padrejta të tregtisë;

b) kufizim i prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik, në dëm të konsumatorëve;

c) zbatim i kushteve jo të njëjta për transaksione të njëjta me palë të tjera tregtare duke i vendosur ato, kështu në disavantazh konkurrues;

d) konkludojnë kontrata ku palët e tjera pranojnë detyrime shtesë, që nga natyra ose për nga përdorimi komercial, nuk kanë lidhje me qëllimin e këtyre kontratave.

#### Neni 86 (1) dhe (2) i Traktatit të KE-së

1. Në rastin e sipërmarrjeve publike dhe sipërmarrjeve të cilave shtetet anëtare u japin të drejta ekskluzive, shtetet anëtare as do të ligjërojnë, as do të mbajnë në fuqi asnjë masë që bie ndesh me rregullat që përmbahen në këtë Traktat, në mënyrë të veçantë atyre rregullave që përmbahen në nenin 12 dhe nenet 81-89.

2. Sipërmarrjet të cilave u është besuar kryerja e shërbimeve që kanë interes ekonomik të përgjithshëm ose që kanë karakterin e një monopoli që prodhon të ardhura do t'u nënshtrohen rregullave që përmbahen në këtë Traktat, në mënyrë të veçantë rregullave mbi konkurrencën, për aq sa zbatimi i këtyre rregullave nuk pengon kryerjen *de jure* apo *de facto*, të detyrave të posaçme që u janë caktuar atyre. Zhvillimi i tregut nuk duhet të cenohet në atë masë që të bjerë ndesh me interesat e Komunitetit.

#### Neni 87 i Traktatit të KE-së

Veç rasteve siç parashikohet në këtë Traktat, çdo ndihmë e dhënë nga një shtet anëtar ose përmes burimeve shtetërore në çfarëdolloj forme, që shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar disa sipërmarrje ose prodhimin e disa të mirave, do të jetë, për aq sa cenon tregtinë mes shteteve anëtare, i papajtueshëm me tregun e përbashkët.

3. Me tregun e përbashkët do të jenë të pajtueshme:

a) ndihma që ka një karakter shoqëror, e cila u jepet konsumatorëve individualë, me kusht që kjo ndihmë të jepet pa diskriminimin në lidhje me origjinën e produkteve në fjalë;

b) ndihma për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose raste të veçanta;

c) ndihma e dhënë për ekonominë e zonave të caktuara të Republikës Federale të Gjermanisë, të cenuara nga ndarja e Gjermanisë, për aq sa kjo ndihmë kërkohet për të kompensuar disavantazhet ekonomike të shkaktuara nga kjo ndarje.

4. Mund të konsiderohen të papajtueshme me tregun e përbashkët:

a) ndihma për të përkrahur zhvillimin ekonomik të zonave ku standardi i jetesës është shumë i ulët ose ku ka papunësi të lartë;

b) ndihma për të nxitur ekzekutimin e një projekti të rëndësishëm me interes të përbashkët europian ose për të ndrequr një çrregullim serioz në ekonominë e një shteti anëtar;

c) ndihma për të lehtësuar zhvillimin e aktiviteteve të caktuara ekonomike ose zonave të caktuara ekonomike, ku një ndihmë e tillë nuk dëmton kushtet e tregtisë në atë masë që të bjerë ndesh me interesin e përbashkët;

d) ndihma për të nxitur ruajtjen e kulturës dhe trashëgimisë ku kjo ndihmë nuk dëmton kushtet e tregtisë dhe konkurrencën në Komunitet, në atë masë që të bjerë ndesh me interesin e përbashkët;

e) kategori të tjera ndihme që mund të caktohen me vendim të Këshillit përmes një shumice të kualifikuar me propozim të Komisionit.

#### SHTOJCA IV

##### Kontributi në buxhet<sup>7</sup>

| Palët                   | Kontributi në përqindje |
|-------------------------|-------------------------|
| Komuniteti European     | 91.2%                   |
| Republika e Shqipërisë  | 0,1%                    |
| Republika e Bullgarisë  | 1%                      |
| Bosnjë-Hercegovina      | 0.3%                    |
| Republika e Kroacisë    | 0.5%                    |
| FYROM                   | 0.1%                    |
| Republika e Malit të Zi | 0.1%                    |
| Rumania                 | 2.1%                    |
| Republika e Serbisë     | 0.7%                    |
| Republika e Turqisë     | 3.8%                    |
| UNMIK                   | 0.1%                    |

#### L I G J

**Nr.9512, datë 10.4.2006**

#### **PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9072, DATË 22.5.2003 “PËR SEKTORIN E ENERGIJËS ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### **K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **V E N D O S I:**

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, bëhen këto ndryshime e shtesa:

#### **Neni 1**

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pikat 22, 23, 30 dhe 33 ndryshohen si më poshtë:

<sup>7</sup> [Tabela do të azhurnohet matematikisht me të dhënat si vijon, nëse Rrepublica e Turqisë nuk do të firmosë Traktatin: “Komuniteti European (94.6%), Republika e Shqipërisë (0.1%), Republika e Bullgarisë (1%), Bosnjë-Hercegovina (0.3%), Republika e Kroacisë (0.5%), FYROM (0.1%), Republika e Malit të Zi (0.1%), Rumania (2.2%), Republika e Serbisë (0.7%), UNMIK (0.1%)”].

“22. “Shoqëri transmetimi” ose “Operatori i sistemit të transmetimit” është personi i licencuar për të kryer veprimtaritë e transmetimit të energjisë elektrike, dispeçerimit të sistemit elektroenergjetik, si dhe për operimin e tregut të energjisë elektrike.

23. “Dispeçerim” është operimi i sistemit elektroenergjetik, në mënyrë që të ruhen balancat ndërmjet prodhimit, import/eksportit dhe konsumit të energjisë elektrike në nivel kombëtar, duke ruajtur sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit.

30. “Furnizim” është lëvrimi dhe shitja e energjisë elektrike te klienti.

33. “Klienti tarifar” është klienti, që furnizohet nga furnizuesi publik me çmime dhe tarifa të rregulluara.”.

2. Pas pikës 30 shtohet pika 30/1 me këtë përmbajtje:

“30/1. “Furnizuesi publik” është personi i licencuar për të furnizuar klientët tarifarë.”.

## Neni 2

Pikat 4 e 7 të nenit 4 ndryshohen si më poshtë:

“4. Ekipi përzgjedhës përbëhet nga dy përfaqësues të Kuvendit, përkatësisht nga Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Ekonominë dhe Financat, si dhe ministri përgjegjës për energjinë. Ekipi përzgjedhës merr vendim me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të tij.

7. Kryetari dhe anëtarët e bordit duhet të jenë persona me arsim të lartë dhe me përvojë:

a) Kryetari të jetë një person i shquar në fushën e elektroenergjetikës. Ai duhet të ketë jo më pak se 15 vjet përvojë pune, prej të cilave jo më pak se 10 vjet në sektorin e energjisë elektrike;

b) njëri nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë pune si inxhinier elektrik në sektorin elektroenergjetik;

c) dy nga anëtarët duhet të jenë ekonomistë dhe të kenë jo më pak se 7 vjet përvojë pune në këtë profesion;

ç) njëri nga anëtarët duhet të jetë jurist dhe të ketë jo më pak se 7 vjet përvojë pune në këtë profesion.”.

## Neni 3

Pas shkronjës “d” të nenit 5 shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) kur nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 4 të ligjit.”.

## Neni 4

Pas pikës 7 të nenit 13 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Çdo person që kërkon të ushtrojë veprimtarinë në këtë fushë duhet të licencohet, sipas këtij ligji, nga ERE-ja.”.

## Neni 5

Në nenin 41 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronja “d” shfuqizohet.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Operatori i sistemit të transmetimit kryen edhe funksionet e operatorit të tregut të energjisë elektrike, në përputhje me aktet e tjera nënligjore në fushën e energjisë elektrike.”.

## Neni 6

Pikat 1 e 2 të nenit 45 ndryshohen si më poshtë:

“1. Furnizimi i përdoruesve të energjisë elektrike kryhet nga shoqëri të licencuara për shpërndarjen dhe/ose furnizimin e energjisë elektrike, për rastin e klientëve tarifarë dhe nga furnizuesit e kualifikuar, në rastin e klientëve me statusin e klientit të kualifikuar.

2. ERE-ja përcakton kriteret e licencimit të “furnizuesve” dhe të “furnizuesve të kualifikuar”.”.

Neni 7

Neni 48 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 48

**Klienti i kualifikuar**

1. Brenda muajit janar të çdo viti, ERE-ja përcakton dhe boton nivelin e konsumit vjetor, si dhe kushtet e tjera, kur një klient mund të marrë statusin e klientit të kualifikuar. ERE-ja miraton një rregullore të veçantë për kriteret e dhënies dhe të heqjes së statusit të klientit të kualifikuar.

2. Pas marrjes së statusit, klienti i kualifikuar ka të drejtë të lidhë kontratë për furnizimin me energji elektrike me çdo furnizues të kualifikuar, vendas ose të huaj, të licencuar nga ERE-ja. Kontrata do të jetë në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara nga ERE-ja.”.

Neni 8

Pika 3 e nenit 52 ndryshohet si më poshtë:

“3. ERE-ja, në licencën e shpërndarjes ose furnizimit me energji elektrike, që i jep operatorëve, përcakton afatin e kohëzgjatjes së periudhës tranzitore, sipas pikës 2 të këtij neni.”.

Neni 9

**Dispozitë kalimtare**

Ekipi përzgjedhës, brenda 2 javëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, verifikon përputhshmërinë e kriterëve të bordit të komisionerëve të ERE-së me kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe, nëse nuk plotësohen kriteret, i propozon Kuvendit lirimin e tyre dhe emërimin në detyrë të personave, në përputhje me përcaktimet e nenit 4 të këtij ligji.

Neni 10

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4846, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**L I G J**

**Nr.9513, datë 10.4.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9268, DATË 29.7.2004 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Shkronja “b” e nenit 7 ndryshohet si më poshtë:  
“b) Kryetari”.

Neni 2

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Këshilli i Autoritetit është organ kolegjal. Ai vendos për politikën në lidhje me realizimin e objektivave të Autoritetit. Këshilli përbëhet nga Kryetari dhe nga gjashtë anëtarë. Anëtarët e Këshillit nuk mund të punësohen në Autoritet.”.

Neni 3

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Anëtari i Këshillit të Autoritetit përfiton një shpërblim mujor të barabartë me 30 për qind të pagës së Kryetarit.”.

Neni 4

Pas shkronjës “k” të pikës 2 të nenit 14 shtohet shkronja “l” me këtë përmbajtje:  
“l) miraton rregulloren e funksionimit të organit ekzekutiv.”.

Neni 5

Pika 2 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:  
“2. Mbledhja e Këshillit thirret dhe drejtohet nga Kryetari, i cili në lajmërimin me shkrim ka përcaktuar më parë rendin e ditës.”.

Neni 6

Pika 2 e nenit 16 shfuqizohet.

Neni 7

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

### **Kompetencat e Kryetarit**

Kryetari i Këshillit është edhe Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit.

Kryetari, në ushtrimin e funksioneve të veta si Drejtor Ekzekutiv, ka për detyrë:

- a) të drejtë dhe të përgjigjet për veprimtarinë e Autoritetit, si dhe ta përfaqësojë atë në marrëdhëniet me të tretët;
- b) të nënshkruajë, në emër të Autoritetit, marrëveshjet në fushën e sigurimeve;
- c) të emërojë punonjësit e Autoritetit, në përputhje me strukturën dhe kriteret e miratuara nga Këshilli;
- ç) të ndjekë zbatimin e vendimeve të Këshillit;
- d) të nxjerrë urdhra dhe udhëzime, në zbatim të vendimeve të Këshillit;
- dh) të ushtrojë kompetencat, që i delegohen nga Këshilli.”.

Neni 8

Nenet 19 dhe 20 shfuqizohen.

Neni 9

Në nenet 14 shkronja “j”, 21, 22, 25 pikat 1 e 4, fjalët “Drejtori Ekzekutiv” zëvendësohen me fjalën “Kryetari”.

Neni 10

Pika 3 e nenit 25 ndryshohet si më poshtë:

“3. Funkcioni i Kryetarit të Këshillit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër, me përjashtim të funksionit si Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit, si dhe me veprimtarinë në fushën e mësimdhënies.”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4847, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468**  
**Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.**

## **BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

|                                                                            |             |
|----------------------------------------------------------------------------|-------------|
| <b>1. PËR PROKURIMIN PUBLIK</b>                                            | <b>1500</b> |
| <b>(2006).....</b>                                                         |             |
| <b>2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)</b>                                       | <b>600</b>  |
| <b>.....</b>                                                               |             |
| <b>3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)</b> | <b>1500</b> |
| <b>4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...( + suplement 2006).....</b>                | <b>1500</b> |
| <br>                                                                       |             |
| <b>1. TREGUESI KRONOLOGJIK I</b>                                           | <b>1500</b> |
| <b>LEGJISLACIONIT.....</b>                                                 |             |
| <b>2. TREGUESI TEMATIK I</b>                                               | <b>2000</b> |
| <b>LEGJISLACIONIT.....</b>                                                 |             |

### **Botime të reja**

|                                                               |             |
|---------------------------------------------------------------|-------------|
| <b>1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....</b> | <b>500</b>  |
| <b>2. KODI</b>                                                | <b>1000</b> |
| <b>DOGANOR.....</b>                                           |             |
| <b>3. KODI DETAR</b>                                          | <b>1000</b> |
| <b>.....</b>                                                  |             |

Hyri në shtyp më 28.4.2006  
Doli nga shtypi më 3.5.2006

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4000 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë